



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCES-**

**Njoftim për shtyp
(06 tetor 2014)**

Mbi trajnimin e administratës publike për çështje të konkurrencës dhe ndihmës shtetërore

Autoriteti i Konkurrencës në bashkëpunim me Sektorin e Ndhmës Shtetërore (pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes) dhe me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) organizoi në ambientet e ASPA-s një trajnim me temë “Çështje të konkurrencës dhe Ndhmës Shtetërore”.

Në fjalën e saj Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës, Znj. Lindita Milo (Lati) falenderoi pjesëmarrësit nga Ministritë e ndryshme dhe theksoi domosdoshmërinë e njohjes nga administrata publike të ligjit dhe politikave të konkurrencës dhe ndihmës shtetërore gjatë procesit të draftimit të akteve ligjore dhe nënligjore dhe dokumentave strategjikë të zhvillimit sipas sektorëve.

Sipas Znj. Lati “Njohja e politikës së konkurrencës është një instrument i rëndësishëm për organet e administratës qendrore dhe vendore për të shmangur paraprakisht(ex-ante) kufizimet e mundshme të konkurrencës si kufizime sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin, vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të veçanta në zona të caktuara dhe/ose për ndërmarrje të caktuara, si dhe imponimin nga ana e institucioneve publike të praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes”.

Trajnimi u zhvillua në datë 24 Shtator 2014, u realizua nga ekspertë të Autoritetit të Konkurrencës dhe synonte rritjen e njohurive të drejtuesve të Ministrive të linjës për ligjin dhe politikën e konkurrencës, si dhe rritjen e bashkëpunimit me institucionet qendrore.

Në këtë aktivitet ishin të ftuar përfaqësues të Drejtorive Juridike të Ministrive përkatëse dhe u trajtuan çështje të zbatueshmërisë së ligjit të konkurrencës, duke u fokusuar veçanërisht në Udhëzimin e Autoritetit të Konkurrencës “Për vlerësimin e pasojave të legjislacionit mbi konkurrencën” në zbatim të nenit 69 dhe 70 të Ligjit nr 9121 , datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Për pjesëmarrësit në këtë trajnim u sqarua mënyra e analizës dhe e vetë-vlerësimit që institucionet publike duhet të kryejnë në rastet e miratimit të një akti normativ, kur mendohet se ka efekte mbi konkurrencën. Për çdo pjesëmarrës në këtë trajnim, u shpërnda edhe broshura përkatëse (botim i Autoritetit të Konkurrencës) i cili përmban Udhëzimin e sipërcituar si dhe pyetësozin që duhet të plotësojnë organet e administratës publike kur kryejnë vetëvlerësimin e një akti normativ.

Gjithashtu, në këtë trajnim u trajtuan edhe rastet hetimore sipas Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), rastet e të drejtave ekskluzive dhe të veçanta dhe mënyra e vlerësimit dhe analizës që kryen Autoriteti i Konkurrencës në këto raste, si dhe kuptimi i nocionit të marrëveshjeve (kordinimi i ofertave) në prokurime publike si dhe raste të shqyrtuara nga Autoriteti i Konkurrencës në lidhje me këto lloj marrëveshje.